



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 24/1 prot.

Shkodër, më 12.01.2023



Lënda: Mbi Vendimin nr. 84, datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS



Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 14, shkronja "f", neni 15, të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.1, shkronja "a", pika 1.3, shkronja "c", neni 18, neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 54, shkronja "dh" dhe "k", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 4, neni 5, neni 6, shkronja b, ç dhe d, neni 7, pika 1, neni 39, neni 40, neni 41, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipëri" i ndryshuar, neni 6, neni 17, neni 32, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 1 prot., datë 04.01.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 23.12.2022", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit¹ të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës & VKB Nr. 86, datë 23.12.2022 "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023", me këto elementa:

1. Buxheti i Bashkisë Vau Dejës, ka burime buxhetore për vitin 2023 në vlerën totale prej 913.987 mijë lekë, nga ku transferata e pakushtëzuar është 267.764 mijë lekë, transferata e kushtëzuar është 358.161 mijë lekë, transferata e pakushtëzuar sektoriale është 118.044 mijë lekë (në të cilën përfshihen, fondet për konviktet e arsimit parauniversitar 9.077 mijë lekë, arsimi parashkollor, e detajuar personeli mësimor 42.501 mijë lekë, stafi mbështetës 1.047 mije lekë, arsimit parauniversitar 2.559 mije lekë, mbrojtja nga zjarri 13.972 mijë lekë, mbrojtja sociale 19.958 mijë lekë, administrimi i pyjeve 7.184 mijë lekë, rrugët

¹ I miratuar me 20 vota pro

6.306 mijë lekë, ujitja dhe kullimi 13.240 mijë lekë, menaxhimin e mbetjeve urbane 2.200 mijë lekë.

2. Plani i të ardhurave për vitin 2023 është në vlerën 170.018 mijë lekë,
3. Fondi i të ardhurave të trashëguara 879.225 mijë lekë,
4. Fondi rezervë dhe kontigjencë për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 500 mijë lekë ose 0.9% e buxhetit,
5. Investimet e planifikuara për vitin 2023 janë në vlerën prej 94.414 mijë lekë,
6. Numri i punonjësve për vitin 2023 është 388 punonjës,
7. Fondi për mbrojtjen civile (burimet e vetë bashkisë) dhe mbrojtjen nga zjarri për vitin 2023 është planifikuar në vlerën prej 41.204 mijë lekë ose 4.94% e buxhetit të vitit 2023,

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS



VENDIM

Nr. 84, datë 23.12.2022

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2023 – 2025, NUMRIN E PUNONJËSVE TË
BASHKISË VAU DEJËS.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 23.12.2022 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “c”, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;

Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi nr. 8 .date 28.02.2022 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025” dhe shtojcat plotesuese; Udhëzimi Plotesues nr. 23 date 08.07.2022 “Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2023-2025” dhe shtojcat plotesuese ; Shkresa e Ministrise se Financave dhe Ekonomise me Nr. 19206 Prot. datë 19.10.2022. “Dergohet tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023”; Shkresa e Ministrise se Financave dhe Ekonomise me Nr. 22954 Prot. datë 14.12.2022. “Dergohet tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023 Në mbledhjen e datës 23.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2023- 2025, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Miratimin e fondeve buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2023-2025 , të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Miratimin e taveve për çdo program, për vitin 2023- 2025 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës DI të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar), pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- c) Miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe institucioneve në varësi për vitin 2023, sipas tabelës nr. 6, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d) Miratimin e detajimit të shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2023-2025 sipas Tabelës 4 te FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - e) Miratimin e listës së projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas Tabelës 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tabelat shoqeruese:
- a) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2023. sipas tabelës Nr.7 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b) Fondet e trashguara nga viti 2022 “Tabela 5”
3. Fondet e papërdorura në fund te vitit 2022 , me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike dhe të ardhurat e veta, do të jene pjesë e buxhetit te vitit 2023.
4. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
- a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
 - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
 - c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.
5. Efektet e këtij vendimi janë nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të vitit 2023.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për marrjen e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).



Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kundër —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 30.12.2022



BASHKIA VAU DEJES

BUXHETI I VITIT 2023



DHJETOR, 2022

PERMBAJTJA

I. Tavanet perfundimtare të shpenzimeve të PBA për Vitet 2023-2025.....	fq1
TË ARDHURAT VETA TË BASHKISË VAU DEJËS.....	fq. 2
TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE.....	fq. 4
• Taksat vendore	
• Taksa e tabelës	
• Tarifat Vendore	
• Të ardhurat nga Menaxhimi I Pasurive Publike	
Të ardhurat nga Taksat e Ndara.....	fq.10
TRANSFERTA E PAKUSHTZUAR E PERGJITHSHME DHE TRANSFERTA E KUSHTZUAR.....	fq.11
II. Shpenzimet siaps programeve per vitet 2023-2024-2025	
FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE	
PROGRAMI 01110: PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM.....	fq. 11
FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	
PROGRAMI 03140: SHËRBIMET POLICORE VENDORE.....	fq. 14
PROGRAMI 03280: EMERGJENCAT CIVILE.....	fq.15
FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE	
PROGRAMI 04130: MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK.....	fq. 15
PROGRAMI 04220: SHERBIMET BUJQESORE, INSPEKTIMI, SIGURARIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATOREVE.....	fq.16
PROGRAMI 04240: MENAXHIMI I INFRASTRUKTURES SË UJITJES DHE KULLIMI.....	fq. 17
PROGRAMI 04260: ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	fq. 17
PROGRAMI 04520: RRJETI RRUGOR RURAL.....	fq. 18
PROGRAMI 04760: ZHVILLIMI I TURIZMIT.....	fq. 18
FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT	
PROGRAMI 05100: MENAXHIMI I MBETJEVE.....	fq. 19
FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	
PROGRAMI 06140: PLANIFIKIMI URBAN VENDOR.....	fq.20
PROGRAMI 06260: SHERBIMET PUBLIKE VENDORE.....	fq. 21
PROGRAMI 06370: FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME.....	fq. 21
FUNKSIONI 07: SHËNDETËSIA	
PROGRAMI 07220: SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR.....	fq. 22
FUNKSIONI 08: ARGËTIMI; KULTURA DHE FEJA	
PROGRAMI 08130: SPORT DHE ARGËTIM.....	fq. 22
PROGRAMI 08220: TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE.....	fq. 23
FUNKSIONI 09: ARSIMI	
PROGRAMI 09120: ARSIMI BAZE PARASHKOLLOR.....	fq. 23
PROGRAMI 09230: ARSIMI I MESEM I PERGJITHSHEM.....	fq. 24
FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE	
PROGRAMI 10430: KUJDESI SOCIAL PËR FAMILJET DHE FËMIJËT.....	fq. 24
PROGRAMI 10661: STREHIMI SOCIAL.....	fq. 26
LISTA E PROJEKTEVE PER INVESTIMEVE.....	fq. 27
FONDET E TRASHEGUARA.....	fq. 30
TABELA PËRMBLEDHESE E SHPENZIMEVE PER PROGRAMET.....	fq.45

RELACION

Për miratimin e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe Buxhetin e vitit 2023 për Bashkinë Vau Dejës

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA për Vitet 2023-2025

Percaktimi i taveve përfundimtare të shpenzimeve të PBA për vitet 2023-2025, është realizuar bazuar në nenin 9, 34 dhe 41 të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, nenin 37 të ligjit 68/2017 datë 27.4.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Per procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NjQV", Udhezim nr. 8, datë 28.02.2022, Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025" dhe shtojcat plotësuese; Udhezimi nr. 23, datë 08.07.2022 "Per përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025" dhe shtojcat plotësuese; Shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 19206 datë 19.10.2022 "Dërgohet për njoftim transferi të pakushtëzuar dhe specifike, për vitin 2023".

2.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Vau-dejes.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Planifikimi i të ardhurave nga taksat&tarifat është mbështetur në llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e k ryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, të cilat janë të përcaktuara në dokumentin "Pakete Fiskale", e cila përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Vau dejes për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësisve administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:


Politikat incentive në taksat:

- *Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri në 30% nga referenca ligjore, për zonat malore.*
- *Nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukture dhe uljet në nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:*
- *Tarifa të reduktuara deri në 50% për invalidet dhe kryefamiljaret femra që trajtohen me ndihme ekonomike.*

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta realizohet në bashkëpunim me administratën e bashkisë, Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt:

- *përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e Bashkisë Vau dejes.*
- *nepërmjet rritjes së numrit të lejeve të ndertimit.*
- *numrit të bizneseve,*
- *ndryshimeve të perberjes familjare, e ardhur kjo me shume nga ndasite familjare, e cila rrit numrin e k/familjareve, dhe si rrjedhojë edhe e të ardhurave perkatese.*
- *Etj.*

Të Ardhurat e Bashkisë (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit) për 2 vitet e para buxhetore dhe 3 vitet e ardhshme buxhetore paraqiten si në grafikun e mëposhtem:



Të ardhurat e veta të Bashkisë të kategorizuar sipas llojit të të ardhurave, për periudhën 2023-2025, parashikohen në vlerat si më poshtë:

(000/lekë)

vitet	2023	2024	2025
Te ardhurat e veta	170,018	173,820	176,185
Te ardhura nga taksat vendore	62,046	62,941	63,327
Te ardhura nga taksat e ndara	29,596	30,485	30,780
Te ardhura nga tarifet vendore	59,905	61,402	62,279
Te ardhura te tjera	18,471	18,992	19,799

Keto të ardhura janë rishikuar, në tendencën e ndikimit të disa faktorëve si më poshtë:

- Në realizimin e ardhurave gjatë vitit 2022.
- Në saktësimin e të dhënave mbi bazën e taksapaguesve, (sic janë nr. e familjeve, nr. bizneseve,
- Rënia e kërkesave të taksapaguesve për shërbime ndaj bashkisë.
- Etj.

Per vitin 2023, të ardhurat e veta janë parashikuar me zbritje rreth 11%, krahasuar me vitin 2022, këtu kanë ndikuar disa faktore si:

- Planifikimi me rritje për vitin 2022, të disa kategorive të taksave, sic është renta minerare, e cila është planifikuar duke u bazuar në realizimin e viti 2021.
- Planifikimi i tarifës së kontrollit në terren, në vlerë të lartë në vitin 2022, ndërsa për vitin 2023, është saktësuar, duke bërë zbritje plani në krahasim me vitin 2022, duke u bazuar në kërkesat sa më reale të taksapaguesve për leje ndërtimi, si dhe mbi bazën e realizimit të vitit 2022.
- Tarifa për vulosje veterinerë të bagetive të therura, e cila ka qenë e planifikuar për vitin 2022, por me Urdhër Nr. 366, datë 8.9.2021 të Ministrisë Bujqësive, kjo kompetencë i ka kaluar AKU, dhe si rrjedhojë kjo tarifë është hequr për vitin 2023 e në vazhdim.
- Tarifet e pyjeve dhe kullotave, për vitin 2022 janë planifikuar, mbi bazën e fondit pyjor që këna në dispozicion, në një kohë që nuk është shfrytëzuar i gjithi, ndërsa për vitin 2023, është rishikuar, dhe vlerësuar plani sa më real i mundshëm.
- Gjithashtu taksa vendore mbi biznesin e vogël, është hequr, nga ndryshimet e fundit ligjore, pra është zëruar.

- Me vendosjen e sistemit te taksave dhe tarifave vendore, si dhe hedhja e te dhenave mbi sip.e ndertesave, truallit, tokes bujqesore, mbi bazen e sip.te prezumuara per kryefamiljaret, ka qene nje faktor ku ka ndikuar ne planifikimin jo real per vitet e meparshme, per mungese informacioni te te dhenave te sakta mbi pronesine e ketyre objekteve.
 - Ndersa per vitin 2023, eshte analizuar dhe rishikuar, duke u bazuar ne realizimin e vitit 2022, dhe sistemit e bere gjate vitit 2022.
 - Po ashtu edhe veshtiresite qe hasen ne mbledhjen e ketyre te ardhurave tek familjaret, ku faktor jane, e para sistemi i adresave, si dhe ne nje faktor i rendesishem eshte edhe emigrimi i banoreve, e sidomos I kryefamiljareve, qe ka ndikuar shume ne zbritjen e ketyre te ardhurave.
- Per vitin 2023, ne krahasim me vitin 2022, ka rritje plani tek tarifat (Pastrim, ndricim, gjelberim),tek institucionet, per arsye se:
- Eshte rritur nr.institucioneve nga 1, ne 2.
 - Ka rritje tek tarifat e transportit, pasi jane vleresuar kerkesat e nje viti me pare, si dhe realizimi i mbledhjes se ketyre tarifave, ne rritje ne krahasim m eplanin e nje viti me pare.
 - Ka rritje tek tatimi mbi te ardhurat personale, faktor ketu eshte realizimi i vitit 2021, pasi kjo e ardhur na vjen si grand nga qeveria qendrore.
- Ndersa per vitin 2024, ne krahasim me vitin 2023, te ardhurat jane parashikuar me nje rritje afro 1-2%, duke pasur parasysht:
- Percaktimit te sakte te kryefamiljareve sipas rregjistrit te gjendjes civile.
 - sistemit e mundshme, nga informacionet e sakta qe mund te na vijne nga ASHK, mbi siperfaqen e ndertesave,
 - deklarimet e sakta nga banoret.
 - Mbeshtetja nga agjentet tatimor
 - Krijimi dhe implementimi i sistemit te taksave vendore, i cili ka ndikuar ne permiresimin e cilesise sakesise se te dhenave si dhe ne zgjerimin e bazes se taksapaguesve, dhe shpejtesise per kryejen e sherbimit,gjithashtu ndikon ne uljen e evazionit fiskal.
 - Shtirirje e mtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të prishëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI.
 - Rritja e nr. te formalizimit te pronave, nepermjet certifikatave te pronesise dhe lejeve te legalizimit.
 - Etj.
- Per vitin 2025, ne krahasim me vitin 2024, eshte parashikuar nje rritje prej 1%, pra duke u bazuar:
- evidentimin e kapaciteteve të reja
 - përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin
 - sensibilizimin, ndergjegjesimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve per komunitetin.

Taksat dhe Tarifat Vendore

Tabela e meposhtme pasqyron planin e te ardhurave te veta , te kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor, ne menyre te detajuar per 3 vitet e ardhshme buxhetore, dhe realizimin, per dy vitet parabuxhetore.

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Fakt 2020	Fakt 2021	I prítshmmi 2022	2023	2024	2025
A	TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	85,427	90,970	192,429	170,018	173,820	176,185
A.I	TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	42,943	53,530	99,367	91,642	93,426	94,107
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	1,264	645	-	-		
I.2	2% tatimi mbi te ardhurat personale		8,822	8,240	8,796	9,060	9,332

1.4	Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	20,796	23,183	52,286	47,994	48,766	49,032
1.4.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	9,436	11,172	20,600	20,266	20,874	21,083
1.4.1.1	<i>Ndërtesa banimi</i>	-	4,008	12,360	12,266	12,634	12,760
1.4.1.2	<i>Ndërtesa të tjera</i>	-	7,164	8,240	8,000	8,240	8,323
1.4.2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	6,505	6,984	22,906	22,238	22,238	22,238
1.4.3	Taksa mbi truallin	4,855	5,027	8,780	5,490	5,654	5,711
1.4.3.1	<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin familje</i>	-	120	290	280	288	291
1.4.3.2	<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin biznes</i>	-	4,907	8,490	5,210	5,366	5,420
1.5	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	75	57	103	100	103	103
1.6	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja	5,850	3,189	20,600	11,952	12,072	12,192
1.7	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	234	-	515	300	309	318
1.8	Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	13,476	16,115	15,450	20,000	20,600	20,600
1.9	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	-	272	10	350	361	371
1.10	Të ardhura nga taksa e akteve të pullë	78	113	103	150	155	159
1.11	Të ardhura nga taksa e tabelës&reklame	1,170	1,134	2,060	2,000	2,000	2,000
A.II	Të ARDHURAT JOTATIMORE	42,484	37,440	93,062	78,376	80,394	82,078
II	Të ardhurat nga Tarifat vendore	27,295	30,688	74,211	59,905	61,402	62,279
II.1	Të ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	19,000	21,722	33,664	32,824	33,809	34,418
II.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	-	6,221	13,884	12,635	13,014	13,405
II.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	-	493	92	500	515	530
II.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	-	15,008	19,688	19,689	20,280	20,483
II.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	2,725	3,683	9,599	7,114	7,324	7,539
II.2.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	-	1,938	7,557	4,928	5,076	5,228
II.2.2	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	-	28	19	136	136	136
II.2.3	Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	-	1,717	2,023	2,050	2,112	2,175
II.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	2,270	2,678	4,684	3,889	3,952	3,975
II.3.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	-	804	2,616	1,643	1,643	1,643
II.3.2	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	-	28	19	136	136	136
II.3.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	-	1,846	2,049	2,110	2,173	2,196
II.3.4	Tarifë e mirembajtjes së infrastruktures së ujtitje-kullim	-	912	4,151	4,151	4,151	4,151
II.4	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	3,300	1,693	22,113	11,927	12,166	12,196
II.4.1	Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	782	197	8,240	300	309	318
II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të thetura	703	766	515	-	-	-
II.4.3	Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	139	89	309	300	309	318
II.4.4	Nga tarifa parkimi për mjetet e licënuara, dhe për vendparkime publike	256	305	309	400	412	424
II.4.5	Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	1,000	-	10,300	10,000	10,300	10,300
II.4.6	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave	256	144	1,688	397	397	397
II.4.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	157	192	515	300	309	309

II.4.8	Nga tarifa për zënie e hapësirave publike			31	30	30	30
II.4.10	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	7	-	206	200	100	100
A III	TË ARDHURA TË TJERA	15,189	6,752	18,851	18,471	18,992	19,799
III.1	Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)	2,026	1,100	2,060	2,650	2,650	2,650
III.2.1	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (ndertese)	116	789	1,358	738	760	783
III.2.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (truall)	318	532	3,688	105	108	111
III.2.3	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (tuke bujqesore)	4,930	1,289	1,038	1,035	1,066	1,098
III.2.4	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota)	978	2,886	10,398	13,783	14,196	14,944
III.3	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime			103	50	50	50
III.4	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	-	-	103	50	50	50
III.5	Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	103	50	50	50
III.6	Të ardhura nga shitja dok. tenderi	14	6		10	10	10
III.7	Të ardhura të tjera (detyrime viti 2019)	7	150		-	52	53
III.8	Të ardhura nga sponsorizimet	6,800	-		-	-	-

Tabela e meposhteme pasqyron të ardhurat sipas njësive administrative:

VITI	TOTALI	NJA VAUDEJES	NJA BUSHAT	NJA HAJMEL	NJA VIG-MNELE	NJA SHLLAK	NJA TEMAL
VITI 2023	170,018	57,059	87,423	17,372	2,842	2,182	3,140
VITI 2024	173,820	59,099	88,648	17,382	3,477	1,738	3,476
VITI 2025	176,185	59,903	89,854	17,619	3,524	1,762	3,523

Peshen kryesore në bazën e taksueshme të të ardhurave të planifikuara, e ze Njesia Administrative Bushat dhe Njesise Administrative Vau-dejes, ndersa njesite e tjera kane nje peshe specifike te vogel, kjo si rrjedhoje e numrit te madh te popullsisë dhe numrit te biznesve, ne keto dy njesi e sidomos ne Nj.A. Bushat, e cila ze afersisht 45 % te popullsisë ne krahasim me totalin.

A. Taksat Vendore

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

Per vitet 2023-2025 parashikohet qe te ardhurat nga taksat vendore te perbejne rreth 54% te totalit te te ardhurave nga burimet e veta te Bashkise.

A.1. Te Ardhura nga Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin (familje, biznes)

Parashikimi për vitet 2023-2025 ka një rritje të lehtë, nga viti në vit, ku bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Percaktimit te sakte te kryefamiljareve sipas rregjistrimit te gjendjes civile.
- Mbështetja nga agjentë tatororë,
- Rritja pak a shume e nr. bizneseve active, duke formalizuar aktivitetet e tyre.
- Rritja e nr. te siperfaqeve te ndertesave nga ndertimet e reja.
- Rritja e nr. te formalizimit te pronave, nepermjet certifikatave te pronesise dhe lejeve te legalizimit.
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, bashkëpunimit të pritsëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI,
 - Krijimi dhe implementimi i sistemit te taksave vendore, i cili ka ndikuar ne permiresimin e cilesise saktetise se te dhenave si dhe ne zgjerimin e bazes se taksapaguesve, dhe shpejtesise per kryejen e shërbimit,gjithashtu ndikon ne uljen e evazionit fiskal.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme ze peshen te madhe rreth 28% te te ardhurave te planifikuara nga taksat vendore, dhe paraqitet ne tabelen e meposhte:

Ne 000/leke

Emertimi/Vitet	2023	2024	2025
Taksa mbi pasurine paluajtshme	47,994	48,766	49,032
Taksa e ndertesave	20,266	20,874	21,083
Taksa e truallit	5,490	5,654	5,711
Taksa mbi token bujqesore	22,238	22,238	22,238

A.2. Taksa e fjetjes ne hotel.

Kjo takse eshte parashikuar nje rritje e vogel prej 3%, jo me shume per arsye te ndryshimit te jetes sociale per shkak te pandemise, si dhe zvogelimit te nr.te shtreturve dhe numrit te vizitoreve ne vendin tone, por kemi ruajtur kete rritje ne vitet e ardhshme, me shpresen e hapjes dhe ardhjes se vizitoreve vendas dhe te huaj.

	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Taksa e fjetjes në hotel	100	103	103

A.3. Taksa e tabelës.

Ne fakt kjo takse per shkak vleres se madhe nga percaktimet ligjore, qe duhet te paguajne subjektet private, kane bere zvogelimin e siperfaqes te tabelave apo reklamave te tyre dhe si rrjedhoje, e ketij indikatorit, nuk kena parashikuar rritje, per arsye edhe te mosrealizimit te te ardhurave nga kjo takse.

	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Taksa e tabelës	2 000	2 000	2 000

A.4. Taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture, eshte parashikuar me rritje, prej 1% nga viti ne vit, per keto arsye:

- Rritjes se numrit te formalizimit dhe pajisjes me leje legalizimi te objekteve te ndertesave te banimit, si dhe certifikimit te tyre.
- Rritja e numrit te dhenies se lejeve te ndertimit, si per shtepi banimi ashtu edhe per aktivite private.

- Rritja dhe ndergjegjesimi i taksapaguesve ne lidhje me shlyerjen e detyrimeve persa i perket pasqisjes me dokumente pronesia, te cilet ndikojne dhe behen indikator rritjeje, te kesaj takse.

	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	11 952	12 072	12 192

B. Tarifat Vendore

Tarifat vendore përfshijnë tarifat për:

a) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve; b) Tarifa per ndricimin, C) Tarifa per gjelberimin, e) tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve; e) tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

B.1. Tarifa për shërbimet publike (pastrim, ndricim, gjelberim)

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për vitin 2023-2025 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 35 % të të ardhurave të veta.

Pjesën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbeturinave me 55 %, gjelbërimi me 6%, ndricimi publik me afro 12%, etj.

	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Te ardhura nga tarifa e pastrimit	32 824	33 809	34 418
Te ardhura nga tarifa e ndricimit	7 114	7 324	7 539
Te ardhura nga tarifa e gjelberimit	3 889	3 952	3 975
Tarifa e mirembajtjes se infrastruktures se ujitje-kullimit	4 151	4 151	4 151

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbim.

Për të incentivuar dhe nxitur zhvillimin e disa kategorive të bizneseve, si dhe duke ju referuar nivelit ekonomiko-social sipas zonave, ngarkesa e tarifimit është shpërndarë gjithashtu duke u bazuar edhe në:

-vendndodhjen

-llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)

-statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulanc etj).

-Xhiron vjetore

Parashikimi në rritje i të ardhurave gjate 2023-2025 bazohet në:

- Planin e menaxhimit te mbetjeve
- Rritjen pak a shume te njësive taksapaguese.
- evidentimin e kapaciteteve të reja
- zgjerimin e mëtejshem të shërbimit edhe ne dy njesi te tjera administrative, dhe si rrjedhoje e rritjes bazës taksapaguese.
- përmirësimin te shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin

B.2. Të ardhura nga shërbimet administrative Bashkise.

Te ardhurat nga shërbimet administrative per periudhen buxhetore 2023-2025, zene rreth 20% te tarifave vendore dhe jane parashikuar si ne tabelen e meposhte:

Emertimi	2023	2024	2025
Tarifa per shërbimin administrativ të bashkisë	11 927	12 166	12 196

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrolle dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj, planfikohet rritje prej 2% të ardhura në vit, të cilat parashikohet të mbulojnë tarifën për kostot administrative për shërbimin që i ofrohen subjekteve.

Të ardhura nga Tarifa e kontrollit të zhvillimit territorit

Kjo Tarife është një tarifë e re e cila ka disa zera mbi të cilat aplikohen tarifën. Është diktuar një rritje e kësaj tarife kjo edhe si pasojë e lejimit dhe lehtësimit të procedurave për dhenie leje ndertimi, dhe ndergjegjësimin e banorëve për formalizimin e ndertimeve.

Të ardhura nga Tarifën e licencimit të veprimtarive të transportit

Plani i të ardhurave parashikon rritje për subjektet që do pajisen pajisen me licencën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë, nisur nga afatet e mbarimit të këtyre licencave.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licensë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi 4+1, dhe taksi 8+1, etj.

Te ardhura nga Tarifa për dhënie licensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon prej 60% të ardhura nga shërbimet administrative.

Të ardhura nga Tarifën e sektorit të pyjeve dhe kullotave

Të ardhurat e parashikuara që zene rreth 1% të të ardhurave administrative, bazohen në trendin e aplikimeve të tarifave të kërkesave për shërbime administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifën e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat janë parashikuara me rritje, dhe bazohen në kategoritë e shumta dhe të ndryshme të shërbimeve që kryhen nga struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, pas ndryshimeve të fundit ligjore të cilat përfshijnë një sërë shërbimesh që do kryhen nga sektori MZSH.

Tarifa për vulosje veterinerë për bagetë të therura, nuk është planifikuar për vitet 2023-2025, për arsye të delegimit të këtij shërbimi nga Bashkia tek AKU.

C. Të ardhurat nga Menaxhimi i Pasurive Publike

Të ardhurat nga menaxhimi i pasurive publike përfshijnë të ardhurat e gjeneruara nga dhënia me qira e tokës bujqësore, Trullit, ndërtesave, fond pyjor etj.

Te ky zë parashikohet të ardhurat nga dhënia me qira të pronave të vetqeverisjes vendore, të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Parashikimi i të ardhurave është bere me një rritje prej afro 3%, duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë, gjithashtu dhe vijimit të certifikimit të tyre dhe dhënia me qira grupeve të interesit.

D. Të Ardhura të Tjera të Veta.

Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative":

Bazuar në Nenin 6.b, "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta".

Bazuar në Nenin 10, "Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative. Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë. Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga gjobat për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake dhe nga Inspektoriati Mbrojtjes Mjedisit, etj.

Parashikimi i të ardhurave me rritje është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shëbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

2.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore, nepermjet agjenteve tatimor, si nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale, taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesisë, Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në këtë nën-seksion.

A. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera. Keto të ardhura mbliidhen nepermjet agjentit tatimor DRT nepermjet degeve perkatese.

B. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përflojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.

Tek ky ze, eshte parashikuar nje rritje per arsye te trendit te rritjes se numrit te automjeteve nga shtetasit, si dhe % se automjeteve me te vjetra se 10 vjet.

C. Renta Minerare

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.

Tek ky ze eshte e pamundur te behet nje planifikim i sakte, per arsye te mos dhenies se informacionit nga institucionet perkatese mbi numrin e subjekteve qe paguajne kete takse, pasi kjo e ardhur na vjen automatikisht nga dega e thesarit, dhe parashikimi eshte bere mbi bazen e realizimit te viteve te kaluara.

- D. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

2.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfera e kushtëzuar

Të ardhurat nga transfera e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfera e kushtëzuar për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Transfera e pakushtëzuar, transfera e pakushtëzuar sektoriale dhe transfera e kushtëzuar për vitet 2023-2025 paraqitet në tabelat me poshtë:

Në lekë			
Viti	2023	2024	2025
Transfera e kushtëzuar	358,161,400	378,161,400	398,161,400
Transfera e pakushtëzuar	267,764,104	267,764,104	279,280,000
Transfera e pakushtëzuar sektoriale	118,044,844	118,044,844	118,044,844
Totali	743,970,348	763,970,348	795,486,244

3. Shpenzimet sipas programeve për vitet 2023-2024-2025

3.1 FUNKSIONI I: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

3.1.1 Nënfunzioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin; • Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj; • Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë; • Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore; • Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
		<ul style="list-style-type: none"> • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj; • Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit; • Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

	<ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i fondeve të gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore. • Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore; • Amortizimi i huave të marra etj.
--	---

Plani i aktivitetit të keshillit bashkiak

Muaji	FUSHA VENDORE
Janar	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Shqyrtim i raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave.
	Informimi i komunitetit dhe transparenca e Këshillit Bashkiak, llogaridhënia e Këshillit Bashkiak, prezantim i raportit vjetor të punës së Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.
Shkurt	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në trajnime për sekretariatit e Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Mars	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Miratimi i raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.
	Shqyrtimi i taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesem në nivel programi.
	Vizite studimore në NJQV brenda vendit.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Prill	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Ndryshim Buxheti.
	Hartim i Planit të Monitorimit të: Shërbimit të pastrimit, Shërbimeve sociale, Arsimit bazë dhe parashkollor, Investimeve publike, etj. Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me keto shërbime, raportim në Këshillë.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Maj	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Paraqitja e raportit për aktivitetin financiar dhe zbatimin e buxhetit vjetor të vitit paraardhës, i cili duhet të jetë i krahasueshëm me planin e buxhetit vjetor.
	Analizë, monitorim i punës së ndërmarrjes Ujesjelles Kanalizime sh.a
	Pjesëmarrje në trajnime për sekretariatit e Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në trajnime për këshilltarët.
	Këshilli zhvillon seancë konsultimi me publikun për projekt aktin e pare të PBA dhe projekt buxhetin vjetor.

Qershor	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Miratim i fazes I të PBA, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave.
	Rishikim buxheti.
	Informim i komunitetit dhe transparenca e veprimtarisë së Këshillit, llogaridhënia e këshillit, promovim i procedurave të ankesave, kërkesave peticioneve dhe nismave qytetare.
	Ceremoni për dhënie tituj nderi.
	Hartim i Planit të Monitorimit të: Shërbimit të pastrimit, Shërbimeve sociale, Arsimit bazë dhe parashkollor, Investimeve publike, etj. Kërkesë drejtuar Bashkisë për të raportuar në lidhje me këto shërbime, raportim në Këshillë.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.
Korrik	Hartimi i raportit të dëgjesave.
	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Miratimi i tavaneve perfundimtare te PBA në nivel programi.
	Ndryshim buxheti.
Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.	
Gusht	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.
Shtator	Mbledhje e Këshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Konsultime me komunitetin për projektin e dytë të PBA dhe të projekt buxhetit vjetor.
	Miratim i projektit të dytë të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, të rishikuar.
	Pjesëmarrje në trajnime për këshilltarët.
	Hartimi i raportit të dëgjesave.;
	Ndryshim buxheti.
	Takim me shoqëri civile, promovim i iniciativave dhe peticioneve qytetare.
	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillin Bashkiak.
Tetor	Mbledhje e Këshillit Bashkiak
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Ndryshim buxheti.
	Monitorim i realizimit të 8-mujorit.
	Vizitë studimore jashtë vendit për Këshillin Bashkiak.
	Këshilli reflekton propozimet e dokumentuara nga konsultimet me publikun dhe në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë për dokumentin e dytë për PBA.

	Pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme vjetore, konferenca dhe aktivitete me interes për Këshillit Bashkiak.
Nëntor	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Këshilli merr nga Kryetari projekt dokumentin përfundimtar të PBA dhe projekt-buxhetin vjetor.
	Kërkesë drejtuar Bashkisë në mbledhjen e këshillit për të reflektuar mendimet e qytetarëve në buxhet.
	Miratim i paketës fiskale.
Dhjetor	Mbledhje e Këshillit Bashkiak.
	Mbledhje e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak.
	Miratimi i buxhetit dhe PBA (faza e tretë).
	Miratim i prioriteteve të investimeve në Bashki.
	Miratim i planit të aktiviteteve të Këshillit.
	Emission në media lokale dhe online për buxhetin.

Tavani i shpenzimeve te programit Planifikimi Menaxhimi dhe Administrim 01110

Viti	EMERTIMI I PROGRAMIT	2023			2024			2025		
KODI				Totali			Totali			Totali
01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrim	176,242,021	2,480,000	178,722,021	190,460,231	960,000	191,420,231	193,314,758	-	193,314,758

3.2 FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

3.2.1 Nënfunzioni 031: Shërbimet policore

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.

Tavani i shpenzimeve te programit Shërbimet e Policisë Vendore 03140

Viti	EMERTIMI I PROGRAMIT	2023			2024			2025		
KODI				Totali			Totali			Totali
03140	Shërbimet Policore VENDORE	8,206,000	-	8,206,000	8,292,397	-	8,292,397	8,446,245	-	8,446,245

3.2.2 Nënfunzioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri

Vështrim i përgjithshëm		
Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përbalimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	<ul style="list-style-type: none"> Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.

Tavani i shpenzimeve te programit Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile 03280

Viti	EMERTIMI I PROGRAMIT	2023			2024			2025		
				Totali			Totali			Totali
03280	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	18,621,749	-	18,621,749	21,158,394	-	21,158,394	21,218,183	-	21,218,183

3.3 FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

3.3.1 Nënfunzioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

Vështrim i përgjithshëm		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor. Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi. Zhvillimi i turizmit.		
Emri i Programit	Përshkrimi i programit	Përshkrimi i aktiviteteve të programit
04130	Mbështetja për zhvillim ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; Funksionimi ose mbështetja me politika v endore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ; Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj; Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj;

		<ul style="list-style-type: none"> • Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin. • Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve; • Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.
